



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit
Ministarstvo za Saobracaj Postu i Telekomunikacije
Ministry of Transport and Communications

RREGULLORJA Nr. 2008/3
MBI KRITERIUMET E SIGURIMIT PËR TRANSPORTUESIT AJROR
DHE OPERATORËT E AVIONËVE

Ministri,

Në pajtim me Nenin 6.1 të Ligjit mbi Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051) të datës 13 Mars 2008,

Duke pasur parasysh nënshkrimin nga ana e UNMIK-ut të Marrëveshjes Multilaterale mbi Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (“Marrëveshja HPEA”) në emër të Kosovës dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes së HPEA-së në Kosovë më datën 10 Tetor 2006,

Duke pasur parasysh se kriteriumet e sigurimit të transportuesve ajror dhe operatorëve të avionëve rregullohen përmes Marrëveshjes së HPEA-së dhe legjislacionit relevant të specifikuar në Shtojcën I të kësaj Marrëveshje,

Me qëllim të krijimit të rregullave dhe procedurave për kriteriumet e sigurimit për transportuesit ajror dhe operatorët e avionëve në përputhshmëri me Marrëveshjen e HPEA-së dhe kërkesës që Rregullorja (EC) Nr. 785/2004 të bëhet pjesë e rregullave të brendshme ligjore të Kosovës,

Me anë të kësaj lëshon Rregulloren në vijim:

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është që të përcakton kriteriumet minimale të sigurimit për transportuesit ajror dhe operatorët e avionëve lidhur me udhëtarët, bagazhin, ngarkesat dhe palët e treta.

2. Lidhur me transportimin e postës, kriteriumet e sigurimit janë ato të përcaktuara në Rregulloren (EEC) Nr 2407/92 dhe në ligjin e aplikueshën në Kosovë.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë Transportuesit Ajrorë dhe të gjithë Operatorët e Avionëve që fluturojnë brenda, për në, jashtë, apo mbi territorin e Kosovës.
2. Kjo Rregullore nuk zbatohet mbi:
 - (a) Avionët shtetërorë si referohen në Nenin 3(b) të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtarë, të nënshkruar në Çikago më datën 7 dhjetor 1944;
 - (b) avionët model me MMNN më të vogël se 20 kg;
 - (c) makina fluturuese që lansohen në këmbë (përfshirë paragljajderët dhe glajderët e varur (hang gliders) me motor);
 - (d) balonat e lidhura;
 - (e) balonë vëzhgimi (në formë të velës; *eng-kites*);
 - (f) parashutat (përfshirë parashutat ngritëse);
 - (g) avionët, përfshirë glajderët me MMNN më të vogël se 500 kg dhe mikro-dritat, të cilat:
 - përdoren për qëllime jo komerciale, ose
 - përdoren për mësim fluturimi në vend që nuk detyron kalimin e kufinjëve ndërkombëtarë,

deri sa obligimet për sigurim sipas kësaj Rregullore që ndërlidhen me rrezikun nga lufta ose terrorizmi kanë të bëjnë.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë Rregullore:

“transportues ajror” do të thotë një ndërmarrës transporti ajror me licencë valide për operim;

“Operator i Avionit” do të thotë një person ose subjekt, që nuk është transportues ajror, i cili ka në dispozicion të vazhdueshëm në mënyrë efektive për të përdorur ose operuar të një avioni; personi fizik ose juridik në emër të të cilit avioni është i regjistruar do të konsiderohet të jetë operator, përveç nëse ai person mund të dëshmojë se një person tjetër është operator;

“Marrëveshja HPEA” do të thotë Marrëveshja Multilaterale në mes të Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të saj, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit;

“Transportues ajror i HPEA-së” do të thotë një transportues ajror i cili është i licencuar si kërkohet nga Marrëveshja e HPEA-së në pajtim me dispozitat e Rregullores (EEC) Nr 2407/92, të specifikuar në Shtojcën i të Marrëveshjes HPEA-së;

“Fluturim” do të thotë:

- sa i përket udhëtarëve dhe bagazhit të pakontrolluar, periudha e transportimit të udhëtarëve me avionë përfshirë hipjen dhe zbritjen e tyre,
- sa i përket ngarkesave dhe bagazhit të kontrolluar, periudha e transportimit të bagazhit dhe ngarkesës nga moment që bagazhi dhe ngarkesa janë dorëzuar tek transportuesi ajror deri në momentin e dërgimit tek marrësi i titulluar,
- sa i përket palëve të treta, përdorimi i avionit nga momenti kur motorët vihen në fuqi me qëllim të ecjes nëpër tokë ose ngritja faktike, deri në momentin kur është në sipërfaqe dhe motorët e saj fikën (ndalohen) plotësisht; përveç kësaj, do të thotë lëvizja e avionit nga automjete për tërheqje ose shtytëse prapa ose me fuqi (motor) të cilat janë tipike për shtyrjen ose ngritjen (me lift) e avionit, në veçanti shtigjet ajrore;

“DST” do të thotë e Drejtë Speciale për Tërheqje si përkufizohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtarë;

“MMNN” do të thotë Masa Maksimale në Ngritje, që korrespondon me sasinë specifike të certifikuar të të gjitha llojeve të avionëve, si deklarohe në certifikatën për gjendje e mirë (airworthiness) të avionit;

“Udhëtarë” do të thotë çdo person i cili është në një fluturim me pëlqim të transportuesit ajror të operatorit të avionit, duke përfshirë anëtarët në detyrë edhe të ekuipazhit të fluturimit edhe të ekuipazhit të kabinës;

“Palë e tretë” do të thotë çdo person juridik apo fizik, duke përfshirë udhëtarët dhe anëtarët në detyrë edhe të ekuipazhit të fluturimit edhe të ekuipazhit të kabinës;

“Operacion Komercial” do të thotë një operacion me pagesës dhe/ose me qira;

“Ministër” do të thotë Ministri i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës;

“Ministria” do të thotë Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës;

“UNMIK” do të thotë Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë;

“Komision” do të thotë Komisioni Evropian;

“Këshill” do të thotë Këshilli Evropian;

Neni 4 Parimet e Sigurimeve

1. Transportuesit Ajror dhe Operatorët e Avionëve që referohen në Nenin 1.1 duhet të sigurohen në pajtim me këtë Rregullore sa i përket përgjegjësisë së tyre specifike të aviacionit lidhur me udhëtarët, bagazhin, ngarkesën dhe palët e treta. Rreziqet e siguruara do të përfshijnë veprimet e luftës, terrorizmit, peng-marrjes, veprimeve të sabotazhës, rrëmbimin e paligjshëm të avionit dhe trazirave civile.
2. Transportuesit ajror dhe Operatorët e Avionit do të sigurojnë se mbulimi me sigurim ekziston për secilën dhe çdo njërin fluturim, pavarësisht se a është avioni që operohet në dispozicionin e tyre përmes posedimit në ndonjë formë të marrëveshjes me qira, ose përmes operacioneve të përbashkëta ose franshizë, kodë të përbashkët ose ndonjë marrëveshje tjetër të natyrës së njëjtë.
3. Kjo Rregullore, pa i përjashtuar rregullat mbi përgjegjësinë, ngrihet nga:
 - Konventat Ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është palë dhe Konventat Ndërkombëtare të cilat janë deklaruar të aplikueshme në Republikën e Kosovës me Ligjin mbi Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051) të datës 13 Mars 2008,
 - Legjislacionit të HPEA-së, dhe
 - Ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës

Neni 5 Përputhshmëria

1. Transportuesit ajror dhe kur është e nevojshme Operatorët e Avionëve, ri referohen në Nenin 2, do të demonstrojnë përputhshmërinë me kriteriumet e sigurimit të përcaktuara në këtë Rregullore duke iu ofruar autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese të HPEA-së të interesuara me depozitimin e certifikatës së sigurimit ose dëshmime të tjera për sigurim valid.
2. Për qëllime të këtij Neni ‘Palë Kontraktuese e interesuar e HPEA-së’ do të thotë Palë Kontraktuese të HPEA-së e cila ia ka dhënë licencën për operim një transportuesi ajror të HPEA-së ose Pala Kontraktuese e HPEA-së ku avioni i operatorit të avionëve është i regjistruar. Për transportues ajror dhe operator të avionëve jo të HPEA-së. që përdorin avionë të regjistruar jashtë HPEA-së, ‘Palë Kontraktuese e interesuar e HPEA-së’ do të thotë Palë Kontraktuese e HPEA-së për ku apo nga ku fluturimet operojnë.

3. Me anë të përjashtimit nga Neni 4.1, në rastet kur Kosova është e mbingarkuar, Ministria mund të kërkojë që Transportuesit Ajror dhe Operatorët e Avionëve të referuar në Nenin 2, të sigurojnë dëshmi për sigurime valide në pajtim me këtë Rregullore.
4. Sa i përket transportuesve ajror dhe operatorëve të avionit të HPEA-së që përdorin avionë të regjistruar në HPEA, depozitimi i certifikatës së sigurimit tek një Palë Kontraktuese të HPEA-së të referuar në Nenin 2.1 është e mjaftueshme për të gjitha Palët Kontraktuese të HPEA-së, pa përjashtuar aplikimin e Nenit 7.6.
5. Në rast të jashtëzakonshme të dështimit të tregut të sigurimeve, Komisioni mund të cakton, në pajtim me procedurën e referuar në nenin 9(2) të Rregullores (EC) Nr 785/2004, masa adekuate për zbatimin e Nenit 5.1 të kësaj Rregullore dhe nenit përkatës të Rregullores (EC) Nr. 785/2004.

Neni 6

Sigurimi lidhur me përgjegjësinë për udhëtarët, bagazhin dhe ngarkesën

1. Për përgjegjësinë sa i përket udhëtarëve, mbulesa minimale e sigurimit është 250 000 DST për udhëtarë. Sa i përket operacioneve jo-komerciale nga avionët me MMNN prej 2 700 kg ose ma pak, për përgjegjësinë sa i përket udhëtarëve, mbulesa minimale e sigurimit është 125 000 DST për udhëtarë.
2. Për përgjegjësinë sa i përket bagazhit, mbulesa minimale e sigurimit është 1000 DST për udhëtarë në operacionet komerciale.
3. Për përgjegjësinë sa i përket ngarkesës, mbulesa minimale e sigurimit është 17 DST për kilogram në operacionet komerciale.
4. Neni 6.1, 6.2 dhe 6.3 nuk zbatohet sa i përket fluturimeve mbi territorin e Kosovës që kryhen nga transportues ajror jo-HPEA dhe nga operatorët e avionëve që përdorin avionë të regjistruar jashtë HPEA-së të cilët nuk përfshijnë aterrimin (zbritjen), ose ngritjen nga territori i Kosovës.
5. Vlerat e referuara në këtë Nen mund të ndryshohen, sipas nevojës, ku ndryshimet në traktatet relevante ndërkombëtare shënojnë domosdoshmërinë e kësaj, në pajtim me procedurën e referuar në Nenin 9(2) të Rregullores (EC) Nr 785/2004.

Neni 7

Sigurimi sa i përket përgjegjësisë për palët e treta

1. Sa i përket përgjegjësisë për palët e treta, mbulesa minimale e sigurimit për aksident, për çdo dhe për secilin avionë, do të jenë:

Kategoria	MMNN (kg)	Sigurimi minimal (milion DST)
1	< 500	0,75
2	< 1000	1,5
3	< 2700	3
4	< 6000	7
5	< 12000	18

6	< 25000	80
7	< 50000	150
8	< 200000	300
9	< 500000	500
10	≥ 500000	700

Nëse në çfarëdo kohe mbulesa e sigurimit për dëme ndaj palëve të treta si pasojë e rrezikut nga lufta ose terrorizmi nuk është në dispozicion për cilindo Transportues Ajror ose Operator të Avionëve në baza për secilin aksident, Transportuesi Ajror ose Operatori i Avionit i tillë mund të përmbush obligimin e tij për sigurimin e rreziqeve të tilla duke bërë sigurimin në bazë të grumbullimit (pjesë pjesë). Grumbullimi i tillë duhet të jetë së paku ekuivalent me shumën relevante të përcaktuar në tabelën e më lartë.

3. Vlerat e referuara në këtë Nen mund të ndryshohen, sipas nevojës, ku ndryshimet në traktatet relevante ndërkombëtare shënojnë domosdoshmërinë e kësaj, në pajtim me procedurën e referuar në Nenin 9(2) të Rregullores (EC) Nr 785/2004.

Neni 8 Zbatimi dhe sanksionet

1. Ministria do të siguron që Transportuesit Ajror dhe Operatorët e Avionëve të referuar në Nenin 2 veprojnë në përputhje me këtë Rregullore.
2. Për qëllime të Nenit 8.1 dhe pa përjashtuar Nenin 8.7, sa i përket mbi-fluturimeve nga transportuesit ajror jo të HPEA-së ose avionëve të regjistruar jashtë HPEA-së të cilët nuk zbritjen ose ngritjen nga territori i Kosovës, si dhe sa i përket ndaljeve në Kosovë nga avionë i tillë për qëllime jo-të qarkullimit (trafikut), Ministria mund të kërkojë dëshmi mbi përputhshmërinë me kriteriumet e sigurimit të parashtruara në këtë Rregullore.
3. Ku është e nevojshme, Ministria mund të kërkojë dëshmi shtesë nga Transportuesit Ajror, Operatori i Avionit ose siguruesi që ka lidhje.
4. Ministria do të vë sanksione në pajtim me Nenin 97.2 të Ligjit mbi Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051) për shkelje të kësaj Rregullore.
5. Sa i përket transportuesve ajror të HPEA-së, këto sanksione mund të përfshijnë tërheqjen e licencës për operim, duke iu nënshtruar dhe në pajtim me dispozitat relevante të legjislacionit të HPEA-së.
6. Sa i përket transportuesve ajror jo-të HPEA-së dhe operatorëve të avionëve që përdorin avionë të regjistruar jashtë HPEA-së, sanksionet mund të përfshijnë refuzimin e të drejtës të zbrasin në tokë në territorin e Kosovës.
7. Ku Ministria nuk është e kënaqur që kushtet e kësaj Rregullore janë përmbushur, nuk do të lejon avionin të ngrihet, para se transportuesi ajror ose operatori i avionit që ka lidhje të ofrojë dëshmi për mbulim adekuatë me sigurim në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 9
Raportimi dhe bashkëpunimi

Me kërkesë, Ministria i ofron informata për zbatimin e kësaj Rregullore Komisionit.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën 20/Nëntor/2008.

Fatmir Limaj

Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit

Datë:03/Nëntor/2008